



## MIRATIMI I LIGJEVE NË KUVENDIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

---

**K**uvendi është organ përfaqësues i qytetarëve dhe bartës i pushtetit legjislativ të Republikës së Maqedonisë, gjegjësisht organ i vetëm i pushtetit shtetëror që ka kompetenca të miratojë ligje.

Shumica e nevojshme për miratimin e ligjeve është e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe me ligj. Në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi mund të vendos, nëse në seancë merr pjesë shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve (kuorumi). Kuvendi vendos me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm, ndërsa së paku me një të tretën e numrit të përgjithshëm të deputetëve (shumica e thjeshtë ose relative), përveç nëse me Kushtetutë nuk është paraparë shumicë e posaçme (shumicë absolute ose e kualifikuar). Gjatë miratimit të ligjeve, të cilat drejtpërsëdrejti kanë të bëjnë me kulturën, përdorimin e gjuhëve, arsimin, dokumentet personale, përdorimin e simboleve, medoemos duhet të ketë shumicë të votave nga deputetët e pranishëm, të cilët u takojnë bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë (shumice e dyfishtë ose e ashtuquajtur shumicë e Badenterit).

Ligjet miratohen në procedurë të definuar qartë (procedura ligjore), të verifikuar me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Procedura ligjore përbënë një sërë hapash, përmes të cilave duhet ta kalojë propozim ligji para se të miratohet. Sipas Rregullores, procedura kalon në tre lexime (me procedurë të rregullt).

Më së shpeshti ligjet miratohen në procedurë të

rregullt, por në raste të caktuara mund të miratohet me procedurë të shkurtuar, ndërsa në raste të jashtëzakonshme me procedurë urgjente.

Të drejtën për të propozuar miratim të ligjit ka çdo deputet, Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe së paku 10,000 votues, të cilët quhen propozues të autorizuar. Iniciativa deri tek propozuesit e autorizuar mund ta dorëzojë çdo qytetarë, grup qytetarësh, institucione dhe shoqata.

Në pajtim e Rregulloren, propozim ligjin propozuesit e autorizuar e dorëzojnë te kryetari i Kuvendit, i cili më pas ua dorëzon deputetëve më shkrim ose në formë elektronike, me çka fillon procedura legjislative.

### LEXIMI I PARË

---

**N**ë kuadër të leximit të parë, trupat punues (komisionet) dhe Kuvendi marrin vendim nëse propozimi ligji është i pranueshëm dhe nëse mund të dorëzohet për lexim të mëtejshëm. Në fillim propozim ligji shqyrtohet në komisionin amë dhe në Komisionin legjislativo-juridik, ndërsa nëse përmban implikacione financiare shqyrtohet edhe në Komisionin për financim dhe buxhet. Në fund shqyrtohet në seancën e Kuvendit.

Komisioni amë dhe Komisioni legjislativo-juridik zhvillojnë diskutim të përgjithshëm për propozim ligjin dhe përgatisin raporte, në të cilat jepet mendim, nëse propozim ligji është i pranueshëm dhe nëse duhet të dorëzohet për lexim të mëtejshëm.

Propozim ligji me tej shqyrtohet në seancën e Kuvendit, ku gjithashtu zhvillohet diskutim i përgjithshëm. Pas diskutimit të përgjithshëm, Kuvendi vendos nëse propozim ligji mund të jepet në lexim të dytë. Nëse Kuvendi vendos se propozim ligji është i pranueshëm dhe mund të jepet në lexim të mëtejme, sjell konkluzion, me çka vazhdon procedura legjislative.

Me të njejtin konkluzion për propozim ligjin, i cili është subjekt i interesit të përgjithshëm, Kuvendi mund të vendos të zbatojë diskutim publik dhe të përcaktojë trupin punues amë, që do ta organizojë diskutimin publik. Trupi punues i autorizuar për organizim të diskutimit publik duhet të mundësojë qasje të propozim ligjit për të gjitha palët e interesuara (qytetarë, ente publike, institucione, OJQ, sindikata etj.), të cilët në afat të caktuar mund të dorëzojnë mendime dhe propozime në lidhje me propozimin. Në bazë të mendimeve dhe propozimeve të tyre, trupi punues amë përgatit raport të shqyrtimit, të cilin së bashku me propozim ligjin e dorëzon për lexim të dytë në Kuvend.

Nëse Kuvendi merr vendim se propozim ligji nuk është i pranueshëm, atëherë ndërpritet procedura legjislative. Pra, në rast të këtyre propozim ligji i njejtë nuk mund të dorëzohet në afat prej tre muajsh.

## LEXIMI I DYTË

**N**ë leximin e dytë përsëri bëhet shqyrtimi i propozim ligjit në trupat punues dhe në seancën e Kuvendit. Në këtë fazë të procedurës mund të dorëzohen amendamente. Amendamenti paraqet propozim për ndryshim ose plotësim të propozim ligjit.

Leximi i dytë fillon me shqyrtimin e propozimit në komisionin amë dhe në Komisionin legjislativo-juridik, të cilët bëjnë shqyrtimin e dispozitave të propozim ligjit dhe amendamenteve të propozuara nga deputetët ose grupet parlamentare dhe votojnë për ta. Në këtë fazë kanë mundësi të dorëzojnë amendamente edhe trupat punues.

Nëse në seancat e trupit punues amë dhe të Komisionit legjislativo-juridik miratohet ndonjë amendament, atëherë këta Komisione pas përfundimit të diskutimit përgaditin propozim ligj të plotësuar (tekst të propozim ligjit në të cilin futen amendamentet e miratuara) me elaborim.

Pas shqyrtimit të propozim ligjit në trupat punues vijon shqyrtimi i tij në seancën e Kuvendit. Në leximin e dytë të ligjit në seancën e Kuvendit zhvillohet diskutim vetëm për nenet e propozim ligjit të ndryshuara me amendamente dhe vetëm për ata nene mund të dorëzohen amendamente. Amendamente mund të dorëzojë çdo deputet, grup parlamentar ose vetë propozuesi.

Amendamenti miratohet me shumicë votash nga deputetët prezent, ndërsa së paku një e treta e numrit të përgjithshëm të deputetëve, pa marrë parasysh shumicën e votave të nevojshme për miratim të ligjit. Amendamenti i dorëzuesit të propozim ligjit dhe amendament, me të cilin ai është pajtuar konsiderohet pjesë përbërëse të propozim ligjit.

Nëse Kuvendi miraton amendamente të më shumë se 1/3 së neneve të propozim ligjit të plotësuar, pas përfundimit të leximit të dytë teksti i ligjit rregullohet nga aspekti juridiko-technik dhe përgatitet për lexim të tretë.

Nëse miratohen amendamente të më pak se 1/3 së neneve të propozim ligjit të ndryshuar, Kuvendi mund të vendos, që leximi tretë i propozim ligjit të zhvillohet në të njëjtën seancë. Kryesuesi i seancës merr vendim nëse leximi i tretë do të bëhet menjëherë pas miratimit të vendimit të theksuar.

Mirëpo, nëse në seancën e Kuvendit gjatë leximit të dytë nuk miratohet asnjë amendament, atëherë nuk bëhet lexim i tretë dhe në të njëjtën seancë kalohet në votim të propozim ligjit në tërësi.

## LEXIMI I TRETË

**N**ë leximin tretë nuk përfshihen trupa punues dhe parimisht ky lexim zhvillohet në seancën e ardhshme plenare pas leximit të dytë.

Edhe në këtë fazë deputetët dhe propozuesi mund të dorëzojnë amendamente, por vetëm për nenet për të cilat janë miratuar amendamente gjatë leximit të dytë të seancës së Kuvendit.

Gjatë leximit të tretë, Kuvendi diskuton dhe merr vendim vetëm për nenet e propozim ligjit të plotësuar, për të cilat janë dorëzuar amendamente dhe merr vendim për propozim ligjin në tërësi.

## PROCEDURA E SHKURTUAR

---

**P**rocedura e shkurtuar për miratim të ligjit mund të zbatohet me kërkesë të propozuesit edhe atë në këta raste: nëse nuk është fjala për ligj të ndërlikuar dhe të vëllimshëm; nëse është anuluar vlefshmëria e ndonjë ligji ose dispozitave të ndonjë ligji, si dhe nëse nuk është fjala për harmonizime të ndërlikuara dhe të mëdha me legjislacionin e BE-së.

Për shqyrtim të propozim ligjit në procedurë të shkurtuar vendos Kuvendi. Nëse vendimi është pozitiv, atëherë kryetar i Kuvendit menjëherë e ngarkon trupin punues amë dhe Komisionin legjislativo-juridik ta shqyrtojnë propozim ligjin.

Trupat punues diskutojnë në procedurë si për lexim të dytë. Kjo do të thotë se diskutohet për nenet e ligjit një nga një si dhe diskutohet dhe merret vendim për amendamentet e dorëzuara. Amendamentet mund të dorëzohen deri në fillim të seancave të trupave punues.

Kur propozim ligji shqyrtohet sipas procedurës së shkurtuar, Kuvendi mban diskutim të përgjithshëm. Leximi i dytë dhe i tretë zhvillohen në seancën e njëjtë të Kuvendit. Në këtë rast leximi i dytë fillon me shqyrtim të propozim ligjit, në procedurë të rregullt sikurse edhe për lexim të dytë të ligjeve që miratohen në procedurë të rregullt. Dallimi qëndron në faktin se amendamentet mund të dorëzohen edhe gjatë seancës, deri në fillimin e leximit të tretë të propozim ligjit.

## PROCEDURA URGJENTE

---

**N**ë raste të veçanta ligji mund të miratohet edhe në procedurë urgjente, por vetëm në këta raste: nëse një gjë e tillë është e patjetërsueshme për shkak të parandalimit dhe evitimit të çrregullimeve më të mëdha të ekonomisë; kur një gjë e tillë e imponojnë interesat e sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit, ose në rast të fatkeqësive të mëdha natyrore, epidemive ose nevojave tjera të jashtëzakonshme dhe të paprolongueshme.

Propozuesi është i detyruar ta elaborojë propozimin për miratimin e ligjit me procedurë urgjente dhe ta dorëzojë propozimin e ligjit, miratimi i së cilit propozohet.

Për arsyeshmërinë e propozimit, Kuvendi merr vendim pa diskutim. Nëse vendimi është pozitiv, Kuvendi e ngarkon trupin punues amë dhe Komisionin legjislativo-juridik të shqyrtojnë për propozim ligjin.

Kur propozim ligji shqyrtohet me procedurë të urgjente, nuk zhvillohet diskutim i përgjithshëm. Leximi i dytë dhe i tretë zhvillohet të njëjtën seancë. Në rast të këtyre leximi i dytë fillon me shqyrtimin e propozim ligjit në pajtim me dispozitat e Rregullores për lexim të dytë. Kur propozim ligji shqyrtohet me procedurë urgjente, atëherë nuk vlejnë kufizimet kohore të theksuara në Rregullore.

## SHPALLJA DHE PUBLIKIMI I LIGJEVE

---

**L**igjet shpallen me dekret, të cilin e nënshkruan kryetari i Republikës së Maqedonisë. Kryetari i Kuvendit menjëherë pas miratimit, ia dorëzon ligjin kryetarit të Republikës së Maqedonisë për nënshkrim të dekretit të shpalljes së tij.

Para se të hyjnë në fuqi, ligjet publikohen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", më së voni në afat prej shtatë ditësh nga dita e miratimit të tyre, ndërsa hyjnë në fuqi më së herët nga dita e tetë e publikimit, përveç në rast të përjashtimeve të përcaktuara nga Kuvendi, që në ditën e publikimit. Ligjet përveç në gjuhën maqedonase publikohen edhe në gjuhën shqipe.

## E DREJTA E VETOS SUSPENDUESE

---

**K**ryetari i Republikës së Maqedonisë mund të vendos të mos e nënshkruajë dekretin e shpalljes së ligjit. Në atë rast, Kuvendi përsëri e shqyrton ligjin dhe nëse e miraton më shumicë votash nga numri i përgjithshëm deputetëve, atëherë kryetari i Republikës është i detyruar ta nënshkruajë dekretin. Kryetari i Republikës e ka për detyrë ta nënshkruajë dekretin dhe nëse ligji miratohet me dy të tretat e shumicës së votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve.

# MIRATIMI I LIGJIT NË PROCEDURË TË RREGULLT NË KUVENDIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

